



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**  
**DREJTORIA E ÇËSHITJEVE JURIDIKE**

Nr. 840/1 Prot

Tiranë, më 31/5/2017

**VENDIM**

Nr. 80, datë 31/5/2017

Në mbështetje të nenit 21, pika 1/b, 3 dhe 4 të ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri")

**VËREN:**

Ankuesit, "Komiteti Shqiptar i Helsinkit" dhe "Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim EDEN" kanë depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën Nr. 840 Prot., datë 22.05.2017, ndaj Organit Publik/Këshilli Kombëtar i Territorit me objekt "Ankim lidhur me cënimin e së drejtës për njoftimin dhe konsultimin publik për Vendimin nr. 6, datë 08.04.2014, "Për miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për ndërtimin e hidrocentralit "Dragobia", Komuna Margegaj, Qarku Kukës".

Pas njohjes me ankesën dhe parashtrimet e bëra në të, rezulton se akti objekt ankimi është miratuar me datë 08.04.2014.

Ligji nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" është miratuar në 30 tetor të vitit 2014 dhe ka hyrë në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare, konkretisht në datë 24 maj 2015. Si rrjedhojë edhe kompetencat e Komisionerit lidhur me trajtimin e ankesave në bazë të nenit 21 të këtij ligji kanë lindur pas hyrjes në fuqi të tij.

Rezulton se, akti objekt ankese është miratuar përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Duke qenë se ligji nuk i shtrin efektet e tij mbi veprime apo akte të miratuara përpara hyrjes në fuqi të tij, ankesa nuk mund të trajtohet nga Komisioneri.

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 21 të ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" dhe shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"

**V E N D O S A:**

1. Rrëzimin e ankesës Nr. 840 Prot., datë 22.05.2017 të Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe Qendrës Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim EDEN kundër Organit Publik/Këshillit Kombëtar të Territorit me objekt "Ankim lidhur me cënimin e së drejtës për njoftimin dhe konsultimin publik për Vendimin nr. 6 datë 08.04.2014 "Për miratimin e Lejes

Zhvillimore Komplekse për ndërtimin e hidrocentralit "Dragobia", Komuna Margegaj, Qarku Kukës".

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
3. Ky vendim u shpall sot me datë 31.5.2017.

